

VENDIM
Nr. 111, datë 27.3.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “TPLANI HC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI “VALBONA”, NË LUMIN E VALBONËS, BASHKIA TROPOJË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2100 kw

(Ndryshuar me Vendimin nr. 108, datë 31.5.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa “a”, dhe 39 pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe neneve 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/17 prot., datë 24.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Tplani HC’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Valbona’, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 27.1.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tplani HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.1.2023 dhe 1.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 99/6 prot., datë 7.2.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi me shkresat e protokolluara në datat 9.2.2023, 15.2.2023 dhe 23.2.2023.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mëtijshme me shoqërinë, me qëllim saktësimin e disa dokumenteve në kuadër të këtij aplikimi, me vendimin e Bordit nr. 57, datë 24.2.2023, u vendos të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Tplani HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresat e protokolluara në ERE në datat 24.2.2023, 3.3.2023, 6.3.2023, 16.3.2023, dhe 23.2.2023, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Tplani HC” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2, germat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “f”.

- Shoqëria nuk ka depozituar lejen për përdorimin e burimit ujq për prodhimin e energjisë elektrike për HEC “Valbonë”, por ka dokumentuar aplikimin dhe ka bërë me dije se është në proces të marrjes së kësaj leje, dhe duke qenë se leja për përdorimin e burimit ujq përbën një dokument thelbësor për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, vlerësohet që shoqëria të licencohet me kushtin që, përpara fillimit të operimit të depozitjës në ERE lejen për përdorimin e burimit ujq.

- Pika e lidhjes e miratuar nga OSHEE sh.a. është për kapacitetin 2.1 MW, në nenin 8.6 të kontratës së koncesionit të nënshkruar me METE-n (Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë), sanksionohet se koncesionari duhet të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentralit “Valbona”, me fuqi totale jo më pak 2300 kw, kurse subjekti vetë ka kërkuar saktësim të fuqisë për 2.4 mw. Në këto rrethana, për sa kohë që nuk ka një miratim tjetër nga operatori i rrjetit, vlerësohet që si kapacitet i instaluar do të merret në konsideratë ai i përcaktuar në pikën e lidhjes së miratuar, prej 2100 kw.

- Kontrata e koncesionit nr. 279 rep., nr. 38 kol., datë 29.1.2009, ka një afat 35-vjeçar, por ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 14 vjet e 2 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 20 vjet e 10 muaj. Ndaj shoqëria do të licencohet për afatin e mbetur.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “TPLANI HC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2100 kw, për një afat 20 vjet e 10 muaj (duke nisur nga data e vendimit nr. 111/2023 deri më datën 27.1.2044).

2. Shfuqizuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti